



Platforma CiviKos është iniciativë e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë, e themeluar për të krijuar dhe avancuar një mjedis të përshtatshëm formal për bashkëpunim të sektorit të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore të Kosovës. Me një rritje të vazhdueshme dhe aktualisht me 243 organizata anëtare, Platforma CiviKos është e angazhuar në thellimin e bashkëpunimit në mes të organizatave anëtare, si dhe me autoritetet publike dhe palët tjera me rëndësi në zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë.

Për të fuqizuar organizimin e brendshëm dhe komunikimin e vazhdueshëm me të gjithë partnerët e saj, Platforma CiviKos kërkon të angazhojë praktikant/e me orar të pjesshëm.

## **PRAKTIKANT/E**

Angazhimi është për periudhën Gusht-Tetor 2019

### ***Detyrat dhe përgjegjësitë***

- Mirëmban bazën e të dhënave në CiviKos;
- Përkrah aktivitetet e Sekretariatit të Platformës CiviKos;
- Ndihmon në koordinim të aktiviteteve të projekteve të CiviKos ;
- Merr pjesë në aktivitetet e organizatave anëtarëve të Platformës të ndërlidhura me CiviKos.
- Ndihmon në organizim të trajnimeve që CiviKos i organizon në qytete të ndryshme të Kosovës.

### ***Kualifikimet e nevojshme***

- Student /e i/e vitit të fundit apo i/e sapo diplomuar në shkencat shoqërore, Fakultetin Juridik, Sociologji, Psikologji etj.
- Njohuri themelore rreth funksionimit të sektorit të shoqërisë civile në Kosovë
- Njohuri të shkëlqyeshme në të folur dhe të shkruar të gjuhës shqipe dhe angleze (njohja e gjuhës serbe është përparësi);
- Njohuri të plota të punës me kompjuter.

### ***Ne ofrojmë:***

- Mundësi për zhvillim profesional;
- Kushte shumë të mira të punës;
- Kompensim të shpenzimeve të praktikantëve.

### ***Të gjithë kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë:***

- Letrën e motivimit (Përse dëshironi të angazhoheni në CiviKos- 1 faqe A4)
- CV-në

Vetëm kandidatët e listës së ngushtë do të kontaktohen.

Ju lutem që dokumentet e plotësuar ti dërgoni në email [info@civikos.net](mailto:info@civikos.net) deri më **16.07.2019**, ora 17:00.